



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M


Nr. 12 datë 31.03.2021

Për autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e subjektit mbështetës për mirëmbajtjen e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 26, pikat 4 dhe 5, të nenit 42 pika 7, të nenit 43, pika 1, shkonja “ç”, të nenit 44 pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave“, i ndryshuar, të nenit 6, nenit 9, nenit 22, pika 3, nenit 27 pikat 1, 2 dhe 3 dhe nenit 28 të Rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruara” të miratuar me Urdhër të Guvernatorit nr. 3762, datë 18.7.2016, të nenit 7, pika 6 të Statutit të Agjencisë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 24, datë 31.10.2018, si dhe të nenit 10, pika 6 dhe të nenit 18, pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e subjektit mbështetës për mirëmbajtjen e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për një periudhë kontraktore një vjeçare.
2. Të miratojë fondin limit prej 4,326,500 (katër milionë e treqind e njëzet e gjashtë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH për përzgjedhjen e subjektit mbështetës për ofrimin e shërbimit me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit Informatik për Raportim dhe kompensim, në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, për një periudhë kontraktore një vjeçare”.



KËSHILLI DREJTUES

3. Efektet financiare në zbatim të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Agjencisë.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar